

#24 



Advocacy Center
for Democratic Culture

DHJETOR
2022

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Prishtina



11TH
Anniversary

INICIATIVAT LOKALE NË LAGJET MULTIETNIKE TË MITROVICËS

Në kuadër të projektit “Promovimi i dialogut ndëretnik në pushtetin lokal”, financuar nga National Endowment for Democracy, janë mbështetur tre projekte të vogla në lagjet multietnike të Mitrovicës.

Iniciativat e projekteve lokale që adresojnë nevojat e komuniteteve lokale janë zhvilluar dhe iniciuar nga komunitetet me mbështetjen e Komiteteve të Komunitetit dhe përfaqësuesve lokal.



Hapësirat e lojërave sportive të përdorura nga të rinjtë dhe të rejtat nga të gjitha komunitetet janë rinovuar në lagjen e Boshnjakëve.



Një kënd lojërash për fëmijë u ndërtua në një ndërtesë të shfrytëzuar nga familje të pafavorizuara sociale në Kodër të Minatorëve.

Puna në Qendrën Kulturore në Kroin e Vitakut, u mbështet me blerjen e pajisjeve të nevojshme.



OJQ ACDC mbështeti iniciativat në të tri vendbanimet multietnike në Mitrovicën e Veriut me qëllim të krijimit të një mjedisi miqësor dhe të qëndrueshëm për komunitete të ndryshme. Nga projektet do të përfitojnë të gjitha grupet, me theks të veçantë në kulturë, për të rinjtë dhe fëmijët. Këto iniciativa të vogla u tregojnë komuniteteve lokale se me pjesëmarrjen e tyre mund të përmirësojmë kushtet e jetesës së të gjitha komuniteteve.

Objektivi i përgjithshëm i projektit “Promovimi i dialogut ndëretnik në pushtetin lokal” është të lehtësojë bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet komuniteteve në komunën e Mitrovicës Veriore.

DITA E TË DREJTAVE TË NJERIUT



Për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, OJQ ACDC organizoi aksionin rrugor në Mitrovicën e Jugut me qëllim të shpërndarjes së informatave dhe përhapjes së vetëdijes për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe rolin dhe kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit në avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Aktiviteti është realizuar në kuadër të projektit "Përkrahje e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës", financuar nga UNMIK-u.

EMISIONE TELEVIZIVE

Jellena Saviq, menaxhere e Qendrës së Biznesit në Zveçan dhe bashkëpunëtore në projektet e OJQ "Santa Maria", foli për pozitën e gruas në veri të Kosovës. Emisioni televiziv u realizua në kuadër të fushatës mediale që synon fuqizimin e grave nga komunitetet joshumicë për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse dhe ndërgjegjësimin e burrave për rëndësinë e përfshirjes së tyre.



Video

Projekti "Gratë për gratë - të bashkuara në pushtet", i zbatuar nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), është mbështetur nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjimore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Suedia. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e OJQ ACDC dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose Suedisë.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E GRANTIT

@ Facebook Advocacy Training and Resource Center - ATRC



OJQ ACDC ishte në mesin e 20 përfituesve që nënshkruan marrëveshje granti me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokimit (ATRC). Projekti do të fillojë që nga janari i vitit 2023 me qëllim rritjen e njohurive për Ligjin e Punës dhe ndërgjegjësimin për pozitën e grave shtatzëna dhe nënave të reja.

Skema e granteve financohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, në kuadër të projektit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cenushme në tregun e punës", i zbatuar nga ATRC në partneritet me BIRN Kosovë.

ANËTARI I EKITIT



OJQ ACDC ka kënaqësinë të ju njoftojë me kolegun tonë të ri Dushan Vukomanović, i cili i është bashkuar ekipit në pozitën e bashkëpunëtorit ligjor.

Dushani ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Para se t'i bashkohej ekipit tonë, ai ka kryer praktikën në zyrën e avokatisë së Dejan A. Vasiq, ku ka fituar përvojë në të drejtën penale, civile dhe familjare.

Jemi të sigurt se ai do të japë një kontribut të madh në punën e ACDC dhe do të ndihmojë ekipin në detyrat tona të përditshme.

11 VJETORI I OJQ ACDC

Muaji dhjetor është veçanërisht i rëndësishëm për ne. Më 29 dhjetor 2011, u krijua OJQ ACDC dhe me ambiciozitet e filloi rrugën e ndryshimit dhe krijimit të një shoqërie më të mirë. Përmes aktiviteteve të projektit dhe avokimit, ne mbetemi të përkushtuar ndaj misionit tonë për identifikimin e nevojave të komunitetit dhe mbështetjen e interesave të qytetarëve dhe shoqërisë kosovare.



OJQ ACDC do të vazhdojë të ndjekë misionin e saj në vitin 2023 dhe do të vazhdojë aktivitetet e saj që synojnë vlerat themelore si kultura demokratike, sundimi i ligjit dhe mundësitë e barabarta për të gjithë.



DEKLARATA NË DITËT NDËRKOMBËTARE

Në dhjetor, OJQ ACDC mbështeti respektimin e ditëve të shumta ndërkombëtare të OKB-së për të rritur njohuritë e publikut dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj disa çështjeve të rëndësishme politike, sociale, kulturore dhe të të drejtave të njeriut, si dhe për të inkurajuar ndryshimet sociale.

Në një deklaratë të lëshuar më 1 dhjetor, OJQ ACDC bëri thirrje për mosdiskriminim ndaj personave HIV pozitiv.



Në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ne theksuam rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjen e barabartë të personave me aftësi të kufizuara në menaxhimin e shoqërisë në të cilën ata jetojnë.



Për nderë të Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, ne kemi inkurajuar qytetarët që të shprehen kundër korrupsionit!



Në Ditën e të Drejtave të Njeriut të shënuar më 10 dhjetor, ACDC lëshoi një deklaratë dhe theksoi rëndësinë e respektimit të parimeve drejtuese të Deklaratës.



Menjëherë pas përfundimit të fushatës 16 Ditët e Aktivizmit, më 11 Dhjetor, kujtuam se parandalimi është mënyra më efektive për të ndaluar dhunën me bazë gjinore.



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Emigrantëve, e cila shënohet çdo 18 Dhjetor, trajtuam problemin e migrantëve.



NË MEDIA



Drejtori Ekzekutiv, Dushan Radaković për RTK 2 për zgjedhjet



Drejtori Ekzekutiv, Dushan Radaković për Radio Gorazhdevac për punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit



Zyrtarja e programit, Ines Aljovic Mihajlovic për Radio Gorazhdevac për të drejtat trashëgimore të grave.



NJOFTIME PËR MEDIA

Tensionet në veri të Kosovës arritën kulmin në fillim të dhjetorit kur serbët e Kosovës ngritën barrikada në të gjithë veriun e Kosovës në shenjë proteste ndaj arrestimit të Dejan Pantic, ish-pjesëtar i Policisë së Kosovës. Me këtë rast, OJQ ACDC, së bashku me organizata të tjera, kanë publikuar një komunikatë për media ku i bëjnë thirrje komunitetit ndërkombëtar dhe institucioneve përkatëse të reagojnë për të mbrojtur të drejtat e z. Pantic, për të komunikuar me avokatët dhe familjen e tij.

[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)

Përveç kësaj, lëshuam një deklaratë ku dënuam ndalimin e hyrjes së Patriarkut serb në Kosovë dhe u kërkojmë autoriteteve të Prishtinës që t'i kërkojnë falje patriarkut, duke pohuar se kriza aktuale në Kosovë nuk duhet të përdoret si justifikim për shkeljen e ligjit dhe kushtetutës.

[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)

Një grup i ndryshëm i organizatave të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia, përfshirë OJQ ACDC, kanë miratuar deklaratën e përbashkët duke bërë thirrje për zëra të rinj konstruktivë – zëra që shikojnë nga e ardhmja.

[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)

Koalicioni i Organizatave Joqeveritare për Vëzhgimin e Zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" (DNV) ka lëshuar një komunikatë për media ku thekson se insistimi për mbajtjen e zgjedhjeve në katër komunat veriore të Kosovës ishte pa takt në rrethanat aktuale.



[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)



Shikoni faqen tonë të internetit të ridizajnuar!



www.acdc-kosovo.org